



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 18-të të KKSB-së mbajtur, më 26.04.2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 14,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Fauz Xhemajli, nenkryetar i Komunës,
2. Zymer Kodra, Stacioni Policor në Lipjan
3. Ilir Ademi, FSK,
4. Zaim Baftiu, BIK, anëtar
5. Nazim Gashi, anëtar, drejtor i DMSH-së, Lipjan
6. Haqif Rrustemi, kryesues i EVSB Lipjan
7. Fehmi Gajtani, KLSP, anëtar
8. Alush Bikliqi, anëtar,
9. Ana Guciq, Komuniteti kroat, anëtare
10. Milazim Sadiku, anëtar
11. Bekim Krasniqi, OJQ "YHR" anëtar
12. Muhamet Qeriqi, OJQ "POLIS" anëtar
13. Hasan Luma, anëtar
14. Elmaze Behluli, anëtare
15. Zoran Stanojevic, ZLK

Të tjerë prezent

1. Naser Bytyqi, përkthyes, shqip-serbisht
2. Merita Bytyqi përkthyes, shqip-serbisht

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**

Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës, i përshëndeti të pranishmit, tha më vjen mirë që të gjithë jeni mirë. Pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë, a ka dikush vërejtje apo plotësime. Dhe në vazhdim e lexoi rendin e ditës.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktin nga takimi i kaluar.
2. Raport për gjendjen e sigurisë në teritorin e komunës së Lipjanit (PK, DMSH).
3. Të ndryshme.

Pasataj pyeti se a ka vërejtje apo plotësime.

Me që nuk pati vërejtje as plotësime u aprovua rendi i ditës së propozuar.

Dhe u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 17-të e KKS-së

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi i mbledhjes Fauz Xhemajli, tha se ekstraktin e këtij takimi nuk e qes në votim për shkak të disa gabimeve dhe pres që në seancën e ardhshme të vjen i plotësuar. Pastaj u kalua në pikën e radhës.

II

Raport për gjendjen e sigurisë në teritorin e komunës së Lipjanit (PK, DMSH).

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes Fauz Xhemajli, i dha fjalën Përfaqësuesit të Stacionit Policor në Lipjan, Zymer Kodra, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti për gjendjen e sigurisë në teritorin e komunës së Lipjanit tha se gjendja e sigurisë në komunën tonë vazhdon të jetë e qetë dhe stabile.

Nazim Gashi, tha se me përjashtim të situatës me Covid 19- që po përballemi thuaj se të gjithë, nuk kemi pas diçka të jashtëzakonshme kemi vazhduar me aktivitetet e përditshme.

Haqif Rrustemi, sa i përket situatës së sigurisë nuk kemi pas ndonjë rast të veçantë por nëse ka ndonjë pyetje jemi të gatshëm me u përgjigj.

Me që diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën e vijim.

V

Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes Fauz Xhemajli, tha rreth Planit të Punës së KKS-s a keni marrë ndonjë propozim.

Haqif Rrustemi, në seancën e kaluar të KKS-s kemi diskutuar rreth planit të punës së KKS-s, dhe nuk ka ardh asnjë propozim i shkruar, unë kam bërë një plan me 21 pika dhe e kam dërguar te sektori i Kuvendit por si duket nuk e kanë anëtarët e KKS-s.

Organizata YAHR ka ardhë me 5 propozime të shkruara por njëres prej tyre veç i ka kaluar koha për ditën e tokës.

Fauz Xhemajli, ne jemi me vonesë të planit të punës së KKS-s, dhe duhet ta aprovojmë pasi që jemi shumë vonë.

Bekim Krasniqi, unë nuk mundem ta votoj në plan të cilin nuk e kam para vetës.

Hasan Luma, a kish pas mundësi që planin ta votojmë, tani nëse ka propozime ne mbledhjet ne vijim i votojmë.

Fehmi Gajtani, nuk jam kundër askujt por unë me nivelin qendror kur nuk kam pas ndonjë plan dhe kam arritë disa qëllime për komitetin,nëse kemi ndonjëherë ndonjë propozim për plan e propozojë prap në KKSB.

Bekim Krasniqi,ne kemi dalë me 5 propozime,ose aktivitete siç janë

1. Shënimi i ditës ndërkombëtare të tokës
2. Tryezë me temë dukuritë negative në shkolla dhe mënyrat e parandalimit
3. Shënimi i ditës ndërkombëtare të ambientit
4. 28 qershori dita ndërkombëtare kundër narkotikëve
5. Punëtorja e organizimit të punës vullnetare

E të cilave ua kam cekur edhe koston financiare po ashtu edhe vërejtjen për shkak të pandemisë nëse nuk mund të zhvillohen.

Haqif Rrustemi,nuk e di sa kanë me mujtë me i realizua këto pasi që nuk ka buxhet KKSB-ja për me realizuar aktivitete.

Zymer Kodra,sa i përket pikës së dytë dukuritë negative në shkolla dhe mënyrat e parandalimit ne kemi mbajtë 40-50 ligjërata nëpër shkolla fillore nga klasa 1 deri në klasën 5.

Zaim Baftiu,ne si Këshill i Bashkësisë Islame në Lipjan kemi disa propozime për KKSB siç janë:

Dhuna në familje,

Kujdesi fetar për ambientin,

Çështje e sigurisë në trafik,

Ndalimi i shkaktimit të zjarreve dhe aktivitete tjera të cilat kërkojmë të jenë pjesë e KKSB-s

Haqif Rrustemi, shumica e këtyre aktiviteteve janë të përfshira në planin e punës së KKSB-s.

Fauz Xhemajli kryesuesi i mbledhjes së KKSB-s tha që propozoj që të votohet plani i punës së KKSB-s ashtu siç e diskutuam po ashtu të përfshihen edhe aktivitetet e propozuara.

U konstatua se KKSB ja e aprovoi planin e punës me të gjitha votat prezentë.

SHTOJCË:

**PLANI
VJETOR I VEPRIMIT TË KKSBB PËR VITIN 2021**

Nr	Aktiviteti - Detyra	Afati i kryerjes	Bartësi i aktivitetit	Bashkëpunëtorët	Kostoja financiare	Vërejtje
1	Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve ,parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal	Vazhdimisht	Kryesuesi i KKSBB	Anëtarët tjerë të KKSBB		
2	Ngritja e vetëdijes të qytetarëve të komunës së Lipjanit për rrezikun ndaj zjarrit sidomos për periudhën e korrje –shirjeve.	15. 04-25.05 2021	Kryesuesi i KKSBB	K-danti i NjPZSh, drejtori i DMSH, Stacioni Policor dhe 2 nënstacionet	4650 euro (dalja ne terren, ligjëruesit aparatet KZ,mater. Senzibili-ilustrues etj.	EVSB
3	Gjetja e një zgjidhjeje të pranueshme për trajtimin e qenve endacak	Vazhdimisht	–	DBP, PK		EVSB
4	Plotësimi dhe azhurnimi i portalit “ Së bashku për siguri” i cili është dizajnuar nga OSCE në bashkëpunim me PK e MPB	rregullisht	Anëtarët e KKSBB	EVSB,KLSP,PK institucionet e pushtetit lokal		
5	Identifikimi i brengave të qytetarëve lidhur me sigurinë publike	15. 04 2021	Anëtarët e KKSBB	Komuniteti EVSB		EVSB, KLSP

6	Shtrirja dhe fuqizimi i programit” Vrojtuesi i lagjes” i iniciuar nga ICITAP	30. 06. 2021	EVSB, PK, EVSB	Qytetarët, ShC.		EVSB
7	Studimi i Strategjisë dhe Planit të veprimit për parandalimin e EDhRShT- ndarja e përgjegjëse për institucionet kompetente	25.07. 2021	KKSB	Subjektet sipas Startegjisë dhe PV të QRK		QRK
8	Përpilimi i planeve konkrete për zvogëlimin e brengave-kërcënimeve të identifikuara nga qytetarët e lokaliteteve të ndryshme.	30. 06. 2021	Kryesuesi i KKSB, Shefi i Policisë, DMSH	Varësisht nga lloji i kërcënimit		
9	Implementimi i Planit për veprim në bashkësi – komunitetin konkret .	30. 07. 2021	Varësisht nga lloji i kërcënimit	KKSB		
10	Thirrja dhe mbajtja e takimeve të rregullta të KKSB	Së paku 6 takime brenda vitit kalendarik	Kryesuesi-stafi Ndihmës	Anëtarët e KKSB		Si dhe në raste emergjencash
11	Ndërtimi i besimit në mes të policisë dhe qytetarëve	Çdo ditë	Shefi i policisë	Anëtarët e KKSB		Të hartohet Plan i posaçëm
12	Ndërtimi i besimit në mes të komuniteteve etnike dhe mes bashkësive fetare	Çdo ditë	Liderët e komuniteteve, udhëheqësit e bashkësive fetare	Anëtarët e KKSB		Punë ekipore në terren

13	Organizimi i takimeve të përbashkëta me forumet e sigurisë (KKSB,EVSB KLSP)të komunave fqinje.	Dy herë në vit	Kryesuesi i KKSB , Koordinatori	Kryesuesit e komunave fqinje		
14	Bashkëpunimi me KLSP dhe EVSK për të mbështetur policinë në planifikimin dhe zbatimin e fushatave të vetëdijesimit për siguri në bashkësi.		Kryesuesi i KKSB, k- danti SP LIpjan	Anëtarët e KKSB dhe KLSP, EVSK		
15	Hartimi i procesverbaleve për mbledhjet dhe dërgimi i tyre MPB, MAPL	Pas çdo mbledhje	Sekretaria e KSSB (shërbimi i KKL).	DMSH		Kopjet u dërgohen edhe anëtarëve të KKSB
16	Organizimi dhe mbajtja e takimeve të KKSB me qytetar .	Çdo 6 muaj	Kryesuesi i KKSB, anëtarët tjerë	Institucionet e përfaqësuara në KKSB		
17	Hartimi i Raportit të punës së KKSB për Kuvendin e komunës mbi diskutimet ,vendimet dhe rezultatet e KKSB	Sipas Udhëzimit Administrativ të MPB- MAPL	Kryesuesi, Koordinatori	Procesmbajtësi dhe anëtarët që kanë paraqitur material të shkruar		
18	Shtrirja e mëtejme dhe forcimi i bashkëpunimit të forumeve të sigurisë me institucionet e sigurisë	Me marrëveshje të përbashkët	Kryesuesi	Anëtarët e KKSB		Nëse ka gatish- mëri

19	Inicimi dhe implementimi i fushatave –aksioneve t përbashkëta sezibilizu- ese dhe edukative në lokalitetet periferike dhe specifike	Rregullisht-sipas nevojës	Anëtarët e KKSB	Kryesuesi		
20	Trajnimi fillestar për anëtarët e rinjë të KKSB të cilët marrin këtë detyrë për herë të parë.		Kryesuesi	MPB, OSBE, MAPL		
21	Kërkimi dhe gjetja e donatorëve të mundshëm jashtë institucioneve vendore të cilët do të përkrahnin implementimin e projekteve specifike të propozuara-aprovuara nga KKSB	rregullisht	Anëtarët e KKSB	Propozuesit e projektit		

Meqë diskutime tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15⁴⁵

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i mbledhjes
Fauz Xhemajli